



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .08.2022

MBLEDHJA Nr. 37,
Datë 01.09.2022, ora 09:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 01.09.2022, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 37 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 24.08.2022
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Bindi” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017
3. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 240, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Erdu Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kalis” me kapacitet të instaluar 2138 kW”
4. Mbi miratimin e ndryshimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”
5. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI